Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of North Mitrovica

**Komuna e Mitrovicës Veriore**
**Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit**
**Data: 25/04/2025**

**Për:**
Qendra për Transferim të Dijes dhe Inovacion (QTDI)
info_qtdi@ibcmitrovica.eu

**Lënda:**
Letër qëllimi për bashkëpunim në kuadër të Programit SKAT "Integrated Water Resources Management in Kosovo" (IWRM-K)

I nderuar Z. Gashi,

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 24 prill 2025, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Mitrovicës së Veriut shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me organizatën tuaj në projektin në kuadër të programit IWRM-K.

Ky projekt përputhet me qëllimet tona për ruajtjen dhe përmirësimin e burimeve ujore, dhe ne jemi të gatshëm të kontribojmë në:

- Hartimin e hartës së ndotjes dhe analizën e presioneve mbi resurset ujore;
- Mbështetjen e aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjësuese për komunitetin;
- Zbatimin e zgjidhjeve teknologjike për menaxhim dhe transparencë;
- Promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes përdorimit të ekosistemeve ujore.

Do të angazhohemi në mënyrë konkrete përmes:

1. Dërgimit të një letre pune që konfirmon gatishmërinë tonë për bashkëpunim operacional afatgjatë;
2. Caktimit të një personi kontaktues për koordinim me ekipin e QTDI-së;
3. Pjesëmarrjes në takimin fillestar për përcaktimin e prioriteteve dhe planifikimin e aktiviteteve.

Vlerësojmë këtë mundësi për bashkëpunim dhe jemi të hapur për çdo iniciativë që ndihmon në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal.

Me respekt,
**Z. Fatir Berzati**
Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit
Komuna Mitrovicë e Veriut